



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
Shërbimi Pronësor Juridik



Direktorat za Urbanizam, Katastar i Zastitu Zivotne Sredine - Imovinska pravna sluzba

02.Nr. 060/01-3240-6/25

Datë: 15.08.2025

Në bazë të Nenit 8, Paragrafit 5 të Ligjit Nr. 03/L-139, të datës 26.03.2009, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-205, të datës 28.10.2010; dhe në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës si Organ për Shpronësim 02 Nr.941/01-18567/25; dhe në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit 060/01-3240-6/25, të datë 28.02.2025, për qëllimin e ndërtimit të Kolektorit/Impiantit të ujërave të zeza për nevojat e banorëve të fshatit Brezne, më datën 15.08.2025 miratohet ky:

V E N D I M

Për shqyrtimin e mëtejshëm të iniciativës së Komunës së Dragashit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

- 1. Miratohet për shqyrtim të mëtejshëm:** Iniciativa e Komunës së Dragashit bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës 02 Nr.941/01-18567/25, në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit 060/01-3240-6/25, të datës 28.02.2025, për shpronësimin e pronës së paluajtshme për realizimin e qëllimit publik për ndërtimin e kolektorit/impiantit të ujërave të zeza për nevojat e banorëve të fshatit Brezne;
- 2. Objekt i këtij Vendimi është shpronësimi i tërë Njesisë Kadastrale P-70604004-00750-0, të pronarit Hamdi Krasniqi (Alim) nga fshati Brezne, Komuna e Dragashit, në vendin e quajtur "Parkaq te mulini", livadh i klasës së 4-të me sipërfaqe totale 1987 m²;**
3. Brenda afatit prej 15 ditësh, Vendimi i Kryetarit së bashku me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit 060/01-3240-6/25, të datës 28.02.2025, dhe dokumentet e tjera të nevojshme, do t'i dorëzohen Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme që vepron në kuadër të Ministrisë së Financave;
4. Brenda afatit prej 10 ditësh, Organi për Shpronësim – Shërbimi Pronësor Juridik do t'i dorëzojë palës së emëruar në Pikën 2 të këtij Vendimi, Vendimin e Kryetarit së bashku me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit 060/01-3240-6/25, të datës 28.02.2025, dhe dokumentet e tjera të nevojshme, në përputhje me Nenin 8.7 të Ligjit për Shpronësim;
5. Organi i Shpronësimit dhe Shërbimi Pronësor Juridik, bazuar në kompetencat e tyre, në përputhje me Nenin 8.7 dhe Nenin 3.1, janë të detyruar të përgatisin një Njoftim në të cilin do të përshkruhet dhe arsyetohet qëllimi publik/interesi publik për të cilin është iniciuar procedura e shpronësimit, dhe do t'i informojnë të gjitha palët – pronarët ose mbajtësit e interesit, pra personat që pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën e përmendur, që mund të japin komente ose vërejtje në formë të shkruar lidhur me shpronësimin e përmendur;
6. Gjithashtu, Organi i Shpronësimit - Shërbimi Pronësor Juridik do t'i njoftojë pronarin (mbajtësit potencialë të interesit) dhe palët e interesuara për pronën në fjalë, se do të mbahet një diskutim publik lidhur me shpronësimin e pronës së paluajtshme në vendin ku ndodhet prona;
7. Brenda afatit prej 10 ditësh pas miratimit të këtij Vendimi, Organi i Shpronësimit - shërbimi i autorizuar - do ta publikojë këtë Vendim në njërin nga gazetatat ditore me tirazhin më të madh në Kosovë.

Organi i shpronësimit
Kryetari i Komunës: Dr. Bexhet Xheladini

